
e-Filing

Udhëzuesi i Përdoruesit Deklarata e Tatimit mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi



Autorësia: ikubINFO
Krijuar më: Dhjetor2024

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	4
Hyrje në sistem	4
Deklarata Tatimit mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi.....	5
Periudha e Vlefshmërisë	5
Krijimi i Deklaratës Tatimi mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi	5
Shfaqja e deklaratës dhe shkarkimi i Udhëzuesit Deklarata “Tatim mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi”	8
Data e pritshme e dorëzimit të Deklaratës Tatim mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi	9
Plotësimi i rubrikave të deklaratës dhe validimi sipas rregullave.....	10
Ruajtja dhe dorëzimi	21
Krijimi i deklaratës model “Ndryshim nga tatimpaguesi”	21
Gjenerimi i urdhërpagesës.....	23
Gjoha për deklarim të vonuar	24
Gjoha dhe interesi për pagesë të vonuar të detyrimit	24

Tabela e Figurave

Figure 1. Hyrje në sistem	4
Figure 2. Menuja Tatim Mbi Të Ardhurat Personale na Biznes	6
Figure 3. Nën menutë e Deklaratës Tatim mbi Të Ardhurat e Biznesit	7
Figure 4. Deklarata të Padorëzuara	7
Figure 5. Deklarata të Dorëzuara	8
Figure 6. Detajet e deklaratës.....	9
Figure 7. Deklarata të Padorëzuara	10
Figure 8. Të dhënat e tatimpaguesit deklarues	10
Figure 9. Të ardhurat nga punësimi	11
Figure 10. Të Ardhurat nga Punësimi - rubrikat.....	11
Figure 11. Zbritje nga baza tatimore.....	12
Figure 12. Kompensim për fëmijët në ngarkim	13
Figure 13. Zbritjet total	14
Figure 14. Regjim i vecantë për zbritjet tatimore	15
Figure 15. Regjim i vecantë për zbritjet tatimore - rubrika	16
Figure 16. Regjim i vecantë për zbritjet tatimore	17
Figure 17. Llogaritja e Humbjes	18
Figure 18. Llogaritja e rubrikave (48/49), (50), (51).....	Error! Bookmark not defined.
Figure 19. Deklarata të dorëzuara.....	21

Figure 20. Deklarata model "Ndryshim nga Tatimpaguesi" 22
Figure 21. Gjenerimi i Urdhërpaguesës 23

Hyrje

Ky manual shërben si udhëzues për të gjithë përdoruesit tatimpagues dhe/ose përfaqësuesit të cilët kanë të drejtë të bëjnë dorëzimin e deklaratës elektronike. Çdo tatimpagues do të identifikohet në mënyrë unike në sistemin E-Filing po ashtu edhe në sistemin C@TS.

Hyrje në sistem

Çdo përdorues i sistemit duhet të marrë një ID-i (identifikim) dhe fjalëkalim të caktuar. Çdo hyrje e të dhënave dhe ndryshim regjistrohet në sistem. Kjo siguron që çdo ndryshim i të dhënave gjurmohet në të ardhmen.

Çdo përdorues i cili kërkon të aksesojë llogarinë e tij në eFiling, do t'i shfaqet pamja sipas figurës së mëposhtme:




Figure 1. Hyrje në sistem

Përdoruesi vendos kredencialet: Emër përdoruesi dhe fjalëkalimin përkatës ose zgjedh të aksesojë llogarinë e tij duke klikuar në link E-Albania Login.

Gjuha e përzgjedhur me një nga dy opsionet e shfaqura në listën e varur, Shqip ose Anglisht, mundëson shfaqjen e formave dhe të dhënave në sistem sipas kërkesës së përdoruesit.

Shënim: Me qëllim që të aksesojë llogarinë e tij, përdoruesi duhet të shënjojë kutizën **E lexova dhe bie dakord me termat dhe kushtet e përdorimit**.

Me klikimin e Butoni "Hyr në Sistem", mundësohet aksesimi i të dhënave të llogarisë eFiling.

Deklarata Tatimit mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi

Nëpërmjet sistemit e-Filing tatimpaguesi deklaron dhe dorëzon deklaratën Tatimi mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi. Duke filluar nga Janari 2025 (25-A) tatimpaguesit të cilët kanë të regjistruar përgjegjësinë tatimore Tatimi mbi Të Ardhurat Personale nga Biznesi u mundësohet një formë e re deklarimi elektronik, Deklarata Tatimi mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi

Deklarata Tatimi mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi, përmban llogaritje automatike dhe kontrole të implementuara të cilat mundësojnë dorëzimin e saj sipas rregullave të përcaktuara në ligjin dhe udhëzimin e Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi, për të shmangur çdo gabim të mundshëm njerëzor apo shmangie nga pagesa .

Njëkohësisht çdo funksionalitet ekzistues në sistem është përditësuar për t'i mundësuar si tatimpaguesit ashtu edhe përdoruesit e C@TS të realizojnë deklarin e rezultatit, kryerjen e pagesave përfshirë dhe kriteret e përcaktuara në kuadrin ligjor për përcaktimet e afateve dhe kontabilizimin e detyrimeve për dorëzim apo pagesë të vonuar të lidhura me këtë deklaratë.

Periudha e Vlefshmërisë

Deklarata e Tatimit mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi, e implementuar në përputhje me Formularin e miratuar pjesë e aneksit të Udhëzimit nr.26, datë 08.09.2023, është e vlefshme duke filluar nga 01 Janar 2025, periudha 25-A.

Krijimi i Deklaratës Tatimi mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi

Deklarata Tatimi mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi për tatimpaguesit të cilët kanë datë të vlefshme rregjistrimi më të hershme se 01.01.2025 dhe kanë një rregjistrim aktiv për përgjegjësinë tatimore Tatimi mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi, krijohet automatikisht nga sistemi C@TS në datën 1 Janar, ndërkohë që për tatimpaguesit e rregjistruar përgjatë vitit kalendarik krijohet nga proceset e serverit pas aprovimit të përgjegjësisë tatimore përkatëse.

Deklarata e Tatimit mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi e gjeneruar automatikisht nga sistemi C@TS mund të gjenden në e-Filing duke klikuar në menunë Deklarata, nën menunë Tatim mbi të Ardhurat e Personale nga Biznesi dhe duke përzgjedhur tabelën “Deklarata të Padorëzuara”.




Figure 2. Menuja Tatim Mbi Të Ardhurat Personale nga Biznesi

Cdo tatimpagues aktiv, i regjistruar për përgjegjësinë tatimore “Tatim mbi të Ardhurat nga Biznesi” e aksesojnë këtë deklaratë në E-Filing , ne varesi te statusit te deklarates:

- Deklarata të Padorëzuara
- Deklarata të Dorëzuara
- Deklarata të Refuzuara
- Deklarata të Arkivuara




Figure 3. Nën menutë e Deklaratës Tatim mbi Të Ardhurat e Biznesit

Nën menuja Deklarata të Padorëzuara shfaq të dhëna lidhur me:

- Periudha
- Data e krijimit
- Data e Pritshme e Deklaratës
- Detyrim i Deklaruar
- Kredia Tatimore
- Ndryshim
- Frekuenca e Dorëzimit




Figure 4. Deklarata të Padorëzuara

Nën menuja Deklarata të Dorëzuara shfaq të dhëna lidhur me:

- Periudha
- Data e krijimit
- Data e Pritshme e Deklaratës

- Data e Deklaratës
- Data e Plotësimit
- Data e Vlerësimit Alternativ
- Detyrim i Deklaruar
- Kredia Tatimore
- Modeli i Deklaratës
- Statusi i Deklaratës
- Frekuenca e Dorëzimit




Figure 5. Deklarata të Dorëzuara

Shfaqja e deklaratës dhe shkarkimi i Udhëzuesit Deklarata “Tatim mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi”

Në nën menunë Deklarata të Padorëzuara, shfaqet deklarata me status krijuar, por e padorëzuar, bashkë me detajet e saj.

Përdoruesi klikon mbi ikonën  për të parë detajet e deklaratës.

Udhëzuesi i Deklaratës aksesohet dhe shkarkohet/printohet me sukses duke klikuar mbi link “Shkarko Udhëzimet”.

DEKLARATA E TATIMIT MBI TË ARDHURAT PERSONALE NGA BIZNESI

Shkarko udhëzimin

Tatimpaguesi: Periudha: 23-A

Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm (NIPIT)	<input type="text"/>	Emri Tregtar i Personit të Tatueshëm:	<input type="text" value="TestPITB1"/>
Emri Mbiemri i Personit Fizik	<input type="text"/>	Adresa:	<input type="text" value="test"/>
Qyteti:	<input type="text" value="test"/>	Bashkia/ Komuna	<input type="text"/>
Rrethi:	<input type="text"/>	Numri i Telefonit:	<input type="text"/>
Kodi i aktivitetit ekonomik dhe përkrahimi	<input type="text" value="A114, Kulturimi i kallamshqerit"/>		

Totali i llogaritur në këtë deklaratë nuk merr parasysh asnjë parapagim.

Llogaritja e Rezultatit

Të ardhurat dhe shpenzimet	Të ushtrimit	Tatimore
(8/9) Të ardhura nga punësimi	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Të ardhura nga biznesi		
(10/11) Të ardhura nga aktiviteti ekonomik kryesor	<input type="text"/>	<input type="text"/>
(12/13) Të ardhura nga aktivitete të tjera dhe të ardhura të tjera të shfrytëzimit	<input type="text"/>	<input type="text"/>
(14/15) Të ardhura nga dividendët	<input type="text"/>	<input type="text"/>
(16/17) Të ardhura të tjera nga investimet	<input type="text"/>	<input type="text"/>
(18/19) Të ardhura të tjera	<input type="text"/>	<input type="text"/>

Figure 6. Detajet e deklaratës

Data e pritshme e dorëzimit të Deklaratës Tatim mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi

Deklarata Tatim mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi gjenerohet automatikisht nga sistemi C@TS dhe deklarohet në bazë vjetore. Për këtë qëllim të dhënat e rezultuara nga veprimtaria ekonomike e ushtruar deri 31 dhjetor të vitit paraardhës do të deklarohen brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

Data e Pritshme e Deklaratës
31.03.2025

Figure 7. Data e pritshme e deklaratës

Deklarata e TAPB dorëzohet në sistem nga data 01 e vitit pasardhës dhe deri në datën e pritshme të saj.

Shenim: Për Tatimpaguesin i cili përfundon veprimtarinë përgjatë periudhës kalendarike dhe statusi i tij është Kërkesë për C' rregjistrim, atëherë kjo deklaratë dorëzohet në cdo kohë pas marrjes së këtij statusi, pa kufizim të datës së përcaktuar sipas rregullit të mësipërm.

Data e dorëzimit të deklaratës nga E-Filing, automatikisht shënjohe nga sistemi kur tatimpaguesi e dorëzon deklaratën (klikon mbi butonin Dorëzo). Cdo informacion ruhet në sistem dhe është i gjurmueshëm.

Plotësimi i rubrikave të deklaratës dhe validimi sipas rregullave

Deklarata Tatim mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi (TPAPB), është e vlefshme për plotësim.

Ajo aksesohet nga E-Filing, duke klikuar në menunë Deklarata → nën menu Tatimi mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi.

Në dritaren, Deklarata të Padorëzuara, përdoruesi klikon butonin  si në figurë:




Figure 8. Deklarata të Padorëzuara

Deklarata TAPB shfaqet në ndërfaqe dhe përmban rubrika për të cilat zbatohen rregullat e kontrollit të saktësisë të parambushjes apo edhe të llogaritjes automatike të cilat detajohen si më poshtë:

Të dhënat e tatimpaguesit deklarues

Vlerat e tyre popullohen automatikisht nga sistemi bazuar tek të dhënat e regjistrimit të tatimpaguesit të ndodhura në system. Ato nuk janë të editueshme nga ndërfaqja:

- Rubrika (1) – Numri serial
- Rubrika (2) - Periudha e deklarimit
- Rubrika (3) - Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm (NIPT)
- Rubrika (4) - Emri tregtar i Personit të Tatueshëm,
- Rubrika (5) - Adresa: Qyteti/Komuna/Rrethi
- Rubrika (6) – Numri i Telefonit
- Rubrika (7) - Kodi i aktivitetit ekonomik dhe përshkrimi

DEKLARATA E TATIMIT MBI TË ARDHURAT PERSONALE NGA BIZNESI

Tatimpagues TestPITB1		Periudha: 23-A	
Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm (NIPT)	XXXXXXXXXX	Emri Tregtar i Personit të Tatueshëm:	TestPITB1
Emri Mbiemri i Personit Fizik		Adresa:	test
Qyteti:	test	Bashkia/ Komuna	
Rrethi:		Numri i Telefonit:	
Kodi i aktivitetit ekonomik dhe përshkrimi	A114, Kullivimi i kallamshqerit		

Figure 9. Të dhënat e tatimpaguesit deklarues

E rëndësishme: Informacioni i parambushur për kodin e aktivitetit ekonomik, është parametër i vlefshëm për llogaritjet automatike në cdo rast që tatimpaguesi me të ardhura nga biznesi plotëson kriteret dhe aplikon zbatimin e regjimit të vecante të shpenzimeve.

Kodi i aktivitetit ekonomik i deklaruar nga tatimpaguesi në të dhënat e tij të regjistrimit me datë 01.01 të vitit kalendarik do të jetë informacion i pandryshueshëm i parambushur në rubrikën [7].


Të ardhurat dhe Shpenzimet

Të ardhurat e tatimpaguesit mund të deklarohen si të Ardhura nga Punësimi ose Të ardhura nga Biznesi.

Në Seksionin e të Ardhurave, rubrikat janë të editueshme dhe pranojnë vlera pozitive:

➤ Rubrika (8/9) Të ardhura nga punësimi

Kur plotësohen rubrikat [8;9] me vlera, tatimpaguesi nuk mund të deklarojë të ardhura nga biznesi dhe për të plotësuar këtë kufizim, automatikisht sistemi do të përditësojë me vlerë të paeditueshme rubrikat [10-21].




Llogaritja e Rezultatit		Të ushtrimit	Tatimore
Të ardhurat dhe shpenzimet			
8/9) Të ardhura nga punësimi		500,000	500,000
Të ardhura nga biznesi			
10/11) Të ardhura nga aktiviteti ekonomik kryesor			
12/13) Të ardhura nga aktivitete të tjera dhe të ardhura të tjera të shfrytëzimit			
14/15) Të ardhura nga dividendët			
16/17) Të ardhura të tjera nga investimet			
18/19) Të ardhura të tjera			
20/21) Të ardhurat nga biznesi Total			

Figure 10. Të ardhurat nga punësimi

Nëse rubrikat (8/9) plotësohen me vlera =0 ose lihen bosh, atëherë automatikisht sistemi lejon hedhjen e vlerave për të Ardhurat nga Biznesi (10 -21).

Rubrikat për të Ardhurat nga Biznesi {nga 10.....19} janë të editueshme, si në figurën e mëposhtme.



Llogaritja e Rezultatit		Të ushtrimit	Tatimore
Të ardhurat dhe shpenzimet			
8/9) Të ardhura nga punësimi			
Të ardhura nga biznesi			
10/11) Të ardhura nga aktiviteti ekonomik kryesor		1,000,000	1,000,000
12/13) Të ardhura nga aktivitete të tjera dhe të ardhura të tjera të shfrytëzimit		200,000	200,000
14/15) Të ardhura nga dividendët		400,000	400,000
16/17) Të ardhura të tjera nga investimet		400,000	400,000
18/19) Të ardhura të tjera		200,000	20,000,000
20/21) Të ardhurat nga biznesi Total		2,200,000	22,000,000

Figure 11. Të Ardhurat nga Punësimi - rubrikat

Të ardhura nga biznesi Total (20/21)

Janë rubrika të paeditueshme, plotësohen automatikisht nga sistemi dhe përlogarisin saktë sipas funksionit të implementuar totalin e rubrikave përkatëse:

- Të ardhura total ushtrimore [20] = [10+12+14+16+18]
- Të ardhura total Tatimore [21] = [11+13+15+17+19]

Rubrika [22] Zbritje nga baza tatimore

Zbritjet nga baza tatimore do të mund të përfitohen si nga tatimpaguesit që deklarojnë të ardhura nga punësimi ashtu dhe nga ata që të ardhurat e deklaruar janë si rezultat i të ardhurave nga biznesi.

Rubrika [22] shfaqet e paraplotësuar automatikisht sipas funksionit:

[22] = (9) ose (21) ->nëse 9 ose 21 <=600.000

[22] = 420.000 -> nëse 600.000< (9)ose (21)<=720.000

[22] = 360.000 -> nëse (9) ose 21)>720.000

Pavarësisht parambushjes automatike, Rubrika [22] është e editueshme, por përsa tatimpaguesi nuk mund të zbrësë vlerë më të madhe sesa e ardhura dhe njëkohësisht sesa lejon kriteri ligjor, në sistem është implementuar rregulli:

- vlera e edituar <= vlera e llogaritur e parambushur
- vlera e edituar <= vlera e plotësuar tek [9] ose [21]

ardhurat dhe shpenzimet	Të ushtrimit	Tatimore
/9) Të ardhura nga punësimi		
ardhura nga biznesi		
0/11) Të ardhura nga aktiviteti ekonomik kryesor	1,000,000	1,000,000
2/13) Të ardhura nga aktivitetet të tjera dhe të ardhura të tjera të shfrytëzimit	200,000	200,000
4/15) Të ardhura nga dividendët	400,000	400,000
6/17) Të ardhura të tjera nga investimet	400,000	400,000
8/19) Të ardhura të tjera	200,000	20,000,000
0/21) Të ardhurat nga biznesi Total	2,200,000	22,000,000
2) Zbritje nga baza tatimore		360,000

Figure 12. Zbritje nga baza tatimore

Rubrika(23/24) Kompensim për fëmijët në ngarkim

Rubrika [23] Numri i fëmijëve, është e editueshme dhe plotësohet me vlera >=0

Rubrika (24) Kompensimi për fëmijët në ngarkim = Rubrika (23)Nr.fëmijëve * 48.000 lekë

Kjo rubrikë plotësohet automatikisht dhe është e paeditueshme

Shënim: vlera e zbritur si kompensim për fëmijët në ngarkim nuk mund të tejkalojë nivelin e të ardhurave të punësimit apo të ardhurave në total nga biznesi të tatimpaguesit

te ardhurat ose shpenzimet	i e ushtrimit		tasimore	
(8/9) Të ardhura nga punësimi				
Të ardhura nga biznesi				
(10/11) Të ardhura nga aktiviteti ekonomik kryesor		1,000,000		1,000,000
(12/13) Të ardhura nga aktivitetet të tjera dhe të ardhura të tjera të shfrytëzimit		200,000		200,000
(14/15) Të ardhura nga dividendët		400,000		400,000
(16/17) Të ardhura të tjera nga investimet		400,000		400,000
(18/19) Të ardhura të tjera		200,000		20,000,000
(20/21) Të ardhurat nga biznesi Total		2,200,000		22,000,000
(22) Zbritje nga baza tatimore				360,000
(23/24) Kompensim për fëmijët në ngarkim			Nr. Fëmijëve më pak se 18 vjeç 1	-48,000

Figure 13. Kompensim për fëmijët në ngarkim

Rubrika[25] Zbritje shpenzime për arsimimin e fëmijëve

Rubrika (25) Zbritje shpenzime për arsimimin e fëmijëve, është e editueshme rast se plotësohen kushtet:

- Rubrika (9) ose (21) <1.200.000
- Rubrika [23] numri i fëmijëve _duhet të jetë më i madh se 0.

Rubrika [25] plotësohet sipas kushteve:

- Vlera rubrikës [25] <=100.000

Shënim: Tatimpaguesi nuk mund të zbrësë shpenzime për arsimim të fëmijëve më shumë se 100.000 lekë dhe njëkohësisht kjo zbritje nuk mund të tejkalojë të ardhurat.

Në rast se të ardhurat, rubrika (9) ose (21) >= 1.200.000 dhe rubrika (23) = 0 (numri i femijeve), kriteri konsiderohet i paplotësuar dhe kjo zbritje nuk mund të aplikohet. Rubrika (25) është e paeditueshme dhe nuk lejohet hedhja e vlerave nga përdoruesi.

Rubrika [26] Zbritje për pensionet private

Kjo rubrikë është e editueshme dhe plotësohet sipas kushtit:

Rubrika(26) <= paga minimale *12 muaj

Zbritjet për pensione private të plotësuara në rubrikën [26], lejohen deri ne kufirin e të ardhurave dhe nuk mund ti tejkalojnë ato. Në rast se përdoruesi tenton të plotësojë një vlerë më të madhe se ajo në rubrikat [9] ose [21], atëherë sistemi automatikisht e plotëson këtë rubrikë me vlerën e [9] ose [21].

Rubrika [27] Zbritje total

Kjo rubrikë përfaqëson totalin e zbritjeve të detajuara më lart dhe është e paeditueshme, e plotësuar në mënyrë automatike sipas formulës:

$$(27) = (22) + (24) + (25) + (26)$$

Shënim: Zbritjet në total nuk lejohen me vlerë më të lartë se të ardhurat dhe sipas kontrollit që kryhet nëse tatimpaguesi do të klikojë për të verifikuar saktësinë e formës apo dorëzimin e deklaratës, mesazhi paralajmërues do të shfaqet:

Vlera e Kutisë 27 (Zbritjet Totale) nuk duhet të jetë më e madhe se të Ardhurat (Kutia 9 ose Kutia 21)

Deklarata do të validohet me sukses vetëm në rastet kur totali i zbritjeve [27] <= [9] ose [21]

Llogaritja e Rezultuarit		Të ushtrimit	Tatimore
Të ardhurat dhe shpenzimet			
(8/9) Të ardhura nga punësimi			
Të ardhura nga biznesi			
(10/11) Të ardhura nga aktiviteti ekonomik kryesor	1,000,000		1,000,000
(12/13) Të ardhura nga aktivitete të tjera dhe të ardhura të tjera të shfrytëzimit	200,000		200,000
(14/15) Të ardhura nga dividendët	400,000		400,000
(16/17) Të ardhura të tjera nga investimet	400,000		400,000
(18/19) Të ardhura të tjera	200,000		30,000,000
(20/21) Të ardhurat nga biznesi Total	2,200,000		22,000,000
(22) Zbritje nga baza tatimore			360,000
(23/24) Kompensim për fëmijët në ngarkim		Nr. Fëmijëve më pak se 18 vjeç 1	48,000
(25) Zbritje shpenzime për arsimimin e fëmijëve			0
(26) Zbritje për pensionet private			100,000
(27) Zbritjet Total			508,000

Figure 14. Zbritjet total

Seksioni Regjim i vecantë për zbritjet e shpenzimeve

Rubrika [28] Rregulli i aplikimit të regjimit të vecantë të shpenzimeve

Të drejtën për të aplikuar regjimin e vecantë për zbritje të shpenzimeve e kanë tatimpaguesit të cilët plotësojnë njëkohësisht dy kritere.

- Deklarojnë të ardhura nga biznesi ([20/21]). Për rrjedhojë në rast se tatimpaguesi ka deklaruar të ardhura nga punësimi në rubrikat (8/9) me vlera >0, atëherë rubrika [28] Regjimi i vecantë për zbritjen e shpenzimeve, automatikisht është i paeditueshme dhe nuk lejohet vendosja e shënjesit.
- Qarkullimi vjetor proporcional, rubrika [21] rezulton të jetë me vlerë <=10 000 000 lekë.

Nëse të ardhurat tatimore vjetore të biznesit në total [21] >10.000.000 (llogaritje proporcionale), nuk lejohet vendosja e shënjesit.

Vendosja e shenjuesit për aplikimin e regjimit të vecantë edhe në rast të plotësimit të kriterëve të mësipërme, është opsionale dhe jo e detyrueshme. Tatimpaguesi ka mundësinë në deklaratë të përzgjedhë për të shënuar një të një nga dy alternativat PO/JO.

Shënim: Referuar Udhëzimit 26/2023, neni14, 14.1, është përcaktuar se nëse veprimtaria ekonomike e tatimpaguesit nuk përfshin një vit të plotë, për efekt të vlerësimit nëse subjekti mund të zgjedhë apo jo të zbatojë regjimin e veçantë për deklarimin e shpenzimeve në një shumë të vetme të supozuar, konvertohet e ardhura bruto e periudhës në të ardhur vjetore. Për konvertuar, totalin e të ardhurës për vitin tatimor e pjesëtojmë me numrin e muajve që ka ushtruar veprimtarinë tatimpaguesi gjatë këtij viti tatimor dhe rezultati i të ardhurës mujore llogaritet për vitin e plotë (x12 muaj).

$$E \text{ ardhura proporcionale} = (\text{Rubrika } (21) / \text{numrin e muajve}) \times 12$$

Rubrikat [29] dhe [30] Shpenzime të llogaritura sipas regjimit të veçantë

Rubrikat (31/44)

Kur nuk ka shenjues të aplikuar si edhe nëse **aplikohet shënjuesi [28]= [JO]**, rubrika [29/30] janë inaktive dhe rubrikat e shpenzimeve ushtrimore /tatimore (31- 42) do të jenë të editueshme dhe mund të plotësohen me vlera pozitive.

- Shpenzime ushtrimore: {(31); (33); (35); (37); (39); (41)}
- Shpenzime tatimore: {(32); (34); (36); (38); (40); (42)}



Shprehja	Shprehja	Shprehja
1/292 Shpenzime të llogaritura sipas regjimit të veçantë		
1/322 Kosto e mallrave, prodhimit, apo shërbimeve të shfutura	55,000	55.0
1/342 Shpenzime të punës (pagë + sigurime shpirtërore e shëndetësore)	25,000	25.0
1/343 Shpenzime administrative	20,000	20.0
1/382 Amortizimi	25,000	25.0
1/402 Shpenzime interne dhe shpenzime të tjera të ngjashme	95,000	95.0
1/422 Shpenzime të tjera financiare	95,000	95.0
1/442 Shpenzime të tjera	95,000	95.0
Total	1,000,000	1,000.0

Figure 15. Regjim i vecantë për zbritjet tatimore

Nëse tatimpaguesi ka aplikuar zbritjet e shpenzimeve sipas regjimit të vecantë shënjuesi [28]= [PO]

Rubrika [29] është e editueshme dhe plotësohet me vlera pozitive.

Në çdo rast që përdoruesi plotëson vlera në rubrikën [29]>0, atëherë rubrikat e shpenzimeve ushtrimore: (31); (33); (35); (37); (39); (41) janë të paeditueshme dhe sistemi nuk lejon vendosjen e asnjë vlere.

- Totali i shpenzimeve Ushtrimore Rubrika [43] = [29]

8) De të shikoni regjimin e vecantë për zbritjen e shpenzimeve?		
9/30) Shpenzime të Bazarit sipas regjimit të vecantë	10,000	10,000
1/32) Kalo e mallrave, prodhimit, apo shërbimeve të shitura		
3/34) Shpenzime të punës (paga + sigurime shërbimesi e shëndetësore)		
5/36) Shpenzime administrative		
7/38) Amortizimi		
9/40) Shpenzime interes dhe shpenzime të tjera të ngjashme		
1/42) Shpenzime të tjera financiare		
3/44) Shpenzimet Total	10,000	10,000

Figure 16. Regjim i vecantë për zbritjet tatimore - rubrika

Nëse tatimpaguesi nuk ka plotësuar vlera në rubrikën [29] =0, atëherë ai ka mundësi të plotësojë informacion në rubrikat e shpenzimeve ushtrimore: {(31) ;(33) ;(35); (37); (39); (41)}

Rubrikat janë të editueshme dhe sistemi lejon vendosjen e vlerave positive.

- Totali i shpenzimeve Ushtrimore Rubrika [43] = (31) + (33) + (35) + (37) + (39) + (41)

Përsa l përket rubrikës [30], m.q.s është zgjedhur të aplikohet regjimi i vecantë i zbritjes së shpenzimeve, ajo plotësohet automatikisht dhe është e paeditueshme.

Llogaritjet e rubrikes [30], bazohen mbi informacionin për kodin nace rev2, të aktivitetit kryesor të tatimpaguesit dhe të dhënave referuese të përqindjeve sipas tabela 1, të aplikuara më tej mbi totalin e të ardhurave tatimore të biznesit të rezultuara në rubrikën [21].

Funksioni i llogaritjes paraqitet sipas rregullave mëposhtë:

- Nëse [7] = NACE rev2 Veprimtaria prodhuese, atëherë
[30] = [21] * 0.6
- Nëse [7] = NACE rev2 Tregëtimit me shumicë, atëherë
[30] = [21] * 0.9
- Nëse [7] = NACE rev2 Tregëtimit me pakicë të mallrave dhe transportit individual, atëherë
[30] = [21] * 0.7
- Nëse [7] = NACE rev2 të veprimtarive të shërbimeve, veprimtarive artizanale dhe atyre zejtare atëherë
[30] = [21] * 0.5
- Nëse [7] = NACE rev2 të kodeve të veprimtarive bare, restorante, disko etj atëherë
[30] = [21] * 0.6
- Nëse [7] = NACE rev2 është një individ i vetëpunësuar atëherë
[30] = [21] * 0.3

Shënim: Kur tatimpaguesi ka aplikuar zbritjen sipas regjimit të vecantë të shpenzimeve, ai nuk do të lejohet të plotësojë shpenzime të tjera.

Rubrikat Shpenzimet Tatimore: (32 - 42) janë të paeditueshme.

- Totali i shpenzimeve Tatimore Rubrika [44] = [30]



ID	Emri i shpenzimit	Vlera	Totali
19(30)	Shpenzime të Regjimit sipas regjimit të vecantë	0	84,000
12(32)	Kalim dhe mallra, prodime, apo shërbime të shitura	0	
12(34)	Shpenzime të punës (paga + shërbime shërbimesi e shërbimeve)	20,000	
12(36)	Shpenzime administrative	10,000	
12(38)	Amortizimi	20,000	
16(40)	Shpenzime informacionale dhe shpenzime të tjera të ngjashme	10,000	
12(42)	Shpenzime të tjera financiare	10,000	
12(44)	Shpenzimet Total	130,000	84,000

Figure 17. Regjim i vecantë për zbritjet tatimore

Rubrika [45] Shpenzimet e pazbritshme

Në rubrikën [45], tatimpaguesi plotëson vlerën për shpenzime të pazbritshme.

Rubrika [45] është e editueshme

Shënim: Vlera e shpenzimeve të pazbritshme nuk mund të jetë më e madhe sesa totali i shpenzimeve në rubrikën [44]. Sistemi kryen kontroll dhe në rast të mosplotësimit të këtij kushti vlera do të përditësohet automatikisht.

Seksioni Llogaritja e rezultatit Humbje-Fitim

Rubrikat (46/47) Humbja, plotësohen automatikisht dhe janë të paeditueshme:

- **Humbja ushtrimore _Rubrika [46]**

Llogaritjet kur totali i shpenzimeve ushtrimore është më i lartë se totali i të ardhurave ushtrimore qofshin këto të punësimit apo të ardhura nga biznesi.

Llogaritja:Humbja ushtrimore për rezultatin të ardhura nga Biznesi

$$(46) = (43)-(20) \text{ kur } (43) > (20), \text{ kur } (20) > 0$$

Llogaritja:Humbja ushtrimore për rezultatin të ardhura nga Punësimi

$$(46) = (43)-(8) \text{ kur } (43) > (8), \text{ kur } (8) > 0$$

- **Humbja Tatimore _ Rubrika [47]**

Llogaritjet kur totali i shpenzimeve tatimore është më i lartë se totali i të ardhurave tatimore dhe zbritjeve në total, qofshin këto të ardhura nga punësimi [9] apo të ardhura nga biznesi [21].

Llogaritja: Humbja tatimore për rezultatin e deklarimit **me të ardhura nga Biznesi**

$$(47) = (44) - (45) - (21) + (27) \text{ kur } (44) - (45) + (27) > (21), \text{ kur } (21) > 0$$

Llogaritja: Humbja tatimore për rezultatin e deklarimit **me të ardhura nga Punësimi**

$$(47) = (44) - (45) - (9) + (27) \text{ kur } (44) - (45) + (27) > (9), \text{ kur } (9) > 0$$



34/13) Në anënyrë nga investimet		100,000	100,000
34/17) Të ardhura të tjera nga investimet		60,000	60,000
34/19) Të ardhura të tjera		50,000	50,000
34/21) Të ardhurat nga biznesi Total		210,000	210,000
23) Zbritje nga baza tatimore			210,000
23/24) Kompensimi për fitimet në regjistrim	No. Fëmijëve më pak se 18 (0-9)	1	48,000
25) Zbritje shpenzime për amonimën e fëmijëve			100,000
24) Zbritje për pensionet private			250,000
27) Zbritjet Total			708,000
28) Ose të abazoni regjistrin e veçantë për zbritjen e shpenzimeve?	<input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo		
29/30) Shpenzime të Regjistrimit sipas regjistrimit të veçantë		0	84,000
31/32) Kosta e mallrave, produkteve, apo shërbimeve të shitura		50,000	
33/34) Shpenzime të punës (paga + sigurime shpirtërore e shëndetësore)		20,000	
35/36) Shpenzime administrative		10,000	
37/38) Amortizimi		30,000	
39/40) Shpenzime interes dhe shpenzime të tjera të regjistruara		10,000	
41/42) Shpenzime të tjera financiare		10,000	
43/44) Shpenzimet Total		130,000	84,000
45) Shpenzimet e pabarshme			60,000
Isa/Total			
46/47) Humbja		0	452,000

Figure 18. Llogaritja e Humbjes

Rubrika (48/49) Fitimi

Rubrikat (48/49) Fitimi, janë të paeditueshme dhe llogarisin automatikisht vlerën e fitimit ushtrimor apo tatimor në varësi të llojit të të ardhurave.

- **Fitimi Ushtrimor _ Rubrika [48]**

Llogaritjet kur totali i të ardhurave ushtrimore është më i lartë se totali i shpenzimeve ushtrimore, qofshin këto të punësimit apo të ardhura nga biznesi.

Llogaritja: Fitimi ushtrimor për rezultatin **të ardhura nga Biznesi**

$$(48) = (20) - (43) \text{ kur } (20) > (43)$$

Llogaritja: Fitimi ushtrimor për **të ardhura nga Punesimi**

$$(48) = (8) - (43) \text{ kur } (8) > (43), \text{ kur } (8) > 0$$

Fitimi Tatimor _Rubrika [49]

Llogaritja: Fitimi tatimor për rezultatin e deklaramit **me të ardhura nga Biznesi**

$$(49) = (21) - (27) - (44) + (45) \text{ kur } (21) - (27) + (45) > (44)$$

Llogaritja: Fitimi tatimor për rezultatin e deklaramit **me të ardhura nga Punësimi**

$$(49) = (9) - (27) - (44) + (45) \text{ kur } (9) - (27) + (45) > (44), \text{ kur } (9) > 0$$

Rubrika [50] Tatimi mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi

Tatimi mbi të ardhurat personale nga Biznesi Rubrika [50], plotësohet automatikisht nga sistemi, është e paeditueshme.

Vlera e Llogaritur e Fitimit [49] është baza për llogaritjen e Tatimit mbi të Ardhurat Personale të Biznesit sipas normës progresive të aplikuar për fitim ≤ 14 milion 15% dhe -23% për diferencën e vlerës mbi 14 milion të fitimit.

Rubrika [50] = Fitimi [49]*15%, [49]<14.000.000 milion

Rubrika [50] = 2.100.000+(rubrika [49]-14.000.000) *23% , [49]>14 milion

Shënim: Për totalin e të ardhurave vjetore të biznesit të deklaruar dhe të llogaritura proporcionalisht në vlerën ≤ 14 milion deri në vitin 2029, norma e fitimit e aplikuar është 0%.

[50] Tatimi mbi të ardhurat personale nga biznesi = [49] Fitimi x 0%

➤ Rubrika [51] Tatimi mbi të Ardhurat Personale nga Punësimi

Tatimi mbi të ardhurat personale nga Punësimi, plotësohet automatikisht nga sistemi.

Rubrika [51], është e paeditueshme, dhe llogaritjet e saj aktivizohen kur sistemi identifikon se janë plotësuar të Ardhurave vjetore të punësimit rubrika [9] ka vlerë positive >0 , dhe bazohet mbi rubrikën e Fitimit [49].

Shënim: **Rubrika [51] Tatimi mbi të ardhurat personale nga punësimi është e paaplikueshme, kur të ardhurat e punësimit rezultojnë të barabarta me zero ose Null.**

Funksioni i implementuar parambush automatikisht rubrikën [51] sipas normës progressive të barabartë me 13% për fitim $\leq 2.040.000$ dhe 23% për cdo vlerë që rezulton mbi 2.040.000 milion.

$$\text{Rubrika [51]} = [49] * 13\%, (49) \leq 2.040.000$$

$$\text{Rubrika [51]} = 265.200 + ((49) - 2.040.000) * 23\%, (49) > 2.040.000$$

Rubrikat Tatim i shtyrë dhe kreditim i tatimit të huaj dhe të mbajtur në burim

Rubrikat [52];[53];[54]

Pas llogaritjes së vlerës për: **tatimin mbi të ardhurat nga biznesi [50]/ tatimit mbi të ardhurat nga punësimi [51]**, tatimpaguesit i lind e drejta të zbrësë tatimin mbi të ardhurat personale i cili konsiderohet i shtyrë apo të kreditojë tatimin e paguar jashtë territorit të RSH si dhe atë të mbajtur në burim.

Rubrikat [52], [53], [54] janë të editueshme dhe pranojnë vlera pozitive.

Shënim: Kreditimi nuk mund të jetë më i madh se tatimi i rezultuar [50] Tatimi mbi të ardhurat personale nga biznesi ose [51] Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi. Në cdo rast që vendoset një vlerë më e madhe dhe kushti nuk plotësohet, sistemi përditëson vlerën automatikisht.

Në rast se totali i kreditimeve tejkalon vlerën e tatimit të llogaritur, përdoruesi nuk mund të dorëzojë deklaratën dhe sistemi do ta paralajmërojë atë me mesazhin:

Shuma e kutive 52,53,54 nuk mund ta kalojë vlerën e kutisë 50 ose 51

Deklarata do të validohet me sukses pas përditësimit të vlerave të kreditimit sipas rregullave të mësipërm.

Rubrika [55] Tatimi i detyrueshëm për pagesë

Si rezultat i rubrikave të plotësuar dhe tatimit të llogaritur pasi aplikohen dhe zbritjet apo kreditimet, në rubrikën [55] llogaritet detyrimi për pagesë.

Kjo rubrikë llogaritet automatikisht dhe është e paeditueshme : (

$$[55] = (50) + (51) - (52) - (53) - (54)$$

Ruajtja dhe dorëzimi

Kontrollo saktësinë e formës

Ruaj

Dorëzo

Në pjesen e poshtme të deklaratës ndodhen butonat

Butoni “Kontrollo saktësinë e formës” shërben për të validuar fushat e plotësuar nëse janë në përputhje me rregullat e validimit të implementuara në sistem për këtë deklaratë.

Butoni “Ruaj” shërben për ruajtjen paraprake të deklaratës në status “Të padorëzuar” dhe tatimpaguesi do mund të kryejë ndryshime në të deri në klikimin e butonit “Dorëzo”.

Butoni “Dorëzo”, shërben për dorëzimin final të deklaratës. Kjo deklaratë ruhet në modelin “Normal”.

Pas janë plotësuar rubrikat e deklaratës, përdoruesi, klikon butonin **Kontrollo saktësinë e formës** për të verifikuar saktësinë e saj, dhe nuk ka gabime në plotësim.

Nëpërmjet klikimit të butonave **Ruaj** **Dorëzo** bëhet e mundur ruajtja dhe dorëzimi i deklaratës.

Pas dorëzimit nga tatimpaguesi nëpërmjet butonit Dorëzo, deklarata shfaqet te nënmenuja **“Deklarata të dorëzuara”**, me statusin Gati për procesim. Proceset e serverit do të kryejnë sinkronizimin e saj dhe rregjistrimin e të dhënave në CATS.

Pas dorëzimit të deklaratës ajo është e vlefshme për printim.

Deklarata mund të përzgjidhet me simbolin e shigjetës dhe të printohet me butonin **Printo**.




Figure 19. Deklarata të dorëzuara

Krijimi i deklaratës model “Ndryshim nga tatimpaguesi”


Pas dorëzimit të deklaratës model Normal, tatimpaguesi kryen nga e-Filing ndryshime të saj deri në 36 muaj (3 vite kalendarike) pas afatit të dorëzimit të deklaratës Normale.

Shënim: Në cdo rast se ka një ndryshim të krijuar nga inspektori, kjo deklaratë serish mund të ndryshohet nga tatimpaguesi por vetëm me rritje të detyrimit.

Deklarata model Ndryshim nga Tatimpaguesi, lejohet të krijohet në rast se ekziston një deklaratë paraardhëse me status të regjistruar.

Për tatimpaguesit që kanë dorëzuar deklaratën “Tatim mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi”, të modelit “Normal”, për të njëjtën periudhë tatimore, sistemi mundëson krijimin e deklaratës model “Ndryshim nga Tatimpaguesi”, e cila paraqet të njëjta rregulla dhe kontrole si modeli “Normal” I deklaratës.

Për të krijuar dhe dorëzuar një deklaratë model Ndryshim nga Inspektori ndiqen hapat si më poshtë:

- Tatimpaguesi klikon mbi menunë Deklarata
- Tatimpaguesi klikon nën menunë “Tatimi mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi”
- Tatimpaguesi klikon mbi nën menunë “Deklarata të Dorëzuara”
- Tatimpaguesi klikon mbi rekordin e deklaratës “Tatim mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi” e regjistruar
- Tatimpaguesi klikon butonin 
- Tatimpaguesi plotëson ndryshimet e deklaratës me të njëjtat rregulla validimi si në deklaratën model "Normal"
- Tatimpaguesi klikon butonin Dorëzo




Figure 20. Deklarata model "Ndryshim nga Tatimpaguesi"

Llogaritja e Rezultatit		
Të ardhurat dhe shpenzimet	Të ushtrimit	Tatimore
(8/9) Të ardhura nga punësimi		
Të ardhura nga biznesi		
(10/11) Të ardhura nga aktiviteti ekonomik kryesor	1,000,000	1,000,000
(12/13) Të ardhura nga aktivitetet e tjera dhe të ardhura të tjera të shfrytëzimit	200,000	200,000
(14/15) Të ardhura nga dividendët	400,000	400,000
(16/17) Të ardhura të tjera nga investimet	400,000	400,000
(18/19) Të ardhura të tjera	200,000	20,000,000
(20/21) Të ardhurat nga biznesi Total	2,200,000	22,000,000


Figure 21. Plotësimi i rubrikave të deklaratës modeli Ndryshim nga Tatimpaguesi

Gjenerimi i urdhërpagesës

Për deklaratat e dorëzuara të cilat janë me status “Gati për procesim”, sistemi mundëson gjenerimin e urdhërpagesës bazuar mbi detyrimin e deklaratës, pasi të dhënat e saj nuk janë regjistruar ende në kontabilitet dhe për rrjedhojë proceset e rakordimit nuk janë kryer.

Kjo urdhërpagesë I mundëson tatimpaguesit në një kohë më të shkurtër gjenerimin e urdhërpagesës dhe pagesën e detyrimit.


Përdoruesi ndjek hapat si mëposhtë për gjenerimin e urdhërpagesës:

- Klikon në menunë Deklarata
- Klikon nën menunë "Tatim mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi"
- Klikon Deklarata të Dorëzuara
- Klikon shigjetën në rekordin e deklaratës DE-TAPB "Tatimi mbi të Ardhurat e Korporatës", me status gati për procesim
- Klikon butonin 

Urdhërpagesa gjenerohet me sukses dhe printohet në format PDF nga tatimpaguesi.

Kur deklarata Tatimi mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi kontabilizohet në system dhe statusi i saj ndryshon nga Gati për procesim në statusin Rregjistruar, sistemi mundëson gjenerimin e urdhërpagesës në menunë Kontabilitet → Urdhërpagesat.

Urdhërpagesa e gjeneruar nga Menuja e Kontabilitetit, I mundëson tatimpaguesit të dhënat për detyrimet e papaguara të deklaratës, përfshirë dhe gjokat dhe interesat për pagesë të vonuar të kontabilizuara ose të paregjistruara në një datë të caktuar.



Periudha	Kodi i të Ardhurave tek Numri Serial	Përgjegjësi Tatimore	Lloji i Gjoksis nga Inspektori	Detyrim i Papaguar	Gjoksi e Papaguar	Interes i Papaguar	Tot
→ 23-A, 2023 Janar-Dhjetor	205100	2000, Tatimi mbi të Ardhurat Personale të Biznesit të Vogël	2051, Gjokje inspektori për evazion fiskal dhe fshetje detyrimi për T.A.B.R.V	5,000	0	0	5,00
→ 23-A, 2023 Janar-Dhjetor	270000	2700, Tatimi mbi të ardhurat personale nga Biznesi		1,682,862	56,184	22,224	1,76

Përdoruesi klikon mbi shigjetën → te rekordi që do të përzgjedhë për printim dhe me pas klikon butonin




Figure 22. Gjenerimi i Urdhërpagesës

Urdhërpagesa gjenerohet dhe sistemi shfaq mesazhin e gjenerimit me sukses dhe njëkohësisht ajo shkarkohet e vlefshme për tu printuar në format PDF.

Gjoha për deklarim të vonuar

Për tatimpaguesit të cilët dorëzojnë në sistem deklaratën Tatimi mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi pas datës së pritshme të dorëzimit 31.03.xxxx ose që kanë deklarata me status të padorëzuar, gjenerohet gjoha me vlerë 5.000 lekë.

Gjoha dhe interesi për pagesë të vonuar të detyrimit

Për tatimpaguesit me përgjegjësi tatimore Tatimit mbi të Ardhurat e Personale nga Biznesi, të cilët kryejnë pagesë të vonuar, pra kur data e disponueshme e pagesës apo kredisë së përdorur është më e madhe se data e pritshme e detyrimit, gjenerohet gjoha dhe interesi për pagesë të vonuar.